



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D' Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr.Doc. 202001896/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2020

**Lënda :** Rekomandim për mbrojtjen e fëmijëve/nxënës të arsimit parauniversitar gjatë procesit të mësimit online

**MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**

**SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM**

**ZOTIT OLTJON MUZAKA**

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**

**ZONJËS ZAMIRA GJINI**

**TIRANË**

Të nderuar,

Me lejoni që nëpërmjet këtij komunikimi të ndajmë me Ju, problematikat e evidentuara gjatë situatës së pandemisë Covid-19, lidhur me zbatimin e platformës së mësimit *online*, në vijim të monitorimit dhe trajtimit të rasteve me iniciativë të ndërmarra nga institucionin i Avokatit të Popullit për të garantuar të drejtën e fëmijës për t'u arsimuar.

Gjatë ushtrimit të funksionit kushtetues në periudhën e pandemisë Covid-19, institucioni i Avokatit të Popullit, nga trajtimi i rasteve, ku është cenuar e drejta e fëmijës për t'u arsimuar, ka konstatuar këto problematika thelbësore, si më poshtë vijon:

- së pari, mungesën e pajisjeve të teknologjisë së komunikimit dhe furnizimit me linjë interneti;
- së dyti, lundrimin në internet për një kohë të gjatë e të vazhdueshme, pa filtra sigurie.

Të mësuarit përmes platformave *online* të edukimit, nëpërmjet garantimit të aksesit në internet, si dhe transmetimi i kësaj platforme studimi në një ndër kanalet e Televizionit Publik Shqiptar, është një qasje e re e të nxënësve dhe edukimit, për të gjithë nxënësit në territorin e RSH-së. Për këtë qëllim, MASR ka përgatitur dhe shpërndarë një udhëzues të veçantë, që orienton drejtuesit e institucioneve arsimore dhe mësuesit, për të vijuar mësimin në distance me nxënësit e tyre<sup>1</sup>.

Sikundër, kemi vijuar të adresojmë vlerësimin e nevojave aktuale për të garantuar mbarëvajtjen e procesit të mësimin *online*, kemi kërkuar marrjen e masave konkrete, për zgjidhjen e tyre dhe në funksion të situatës së pandemisë, shkaktuar prej COVID-19. Një ndër problematikat e evidentuara gjatë kësaj periudhe, lidhet me qëndrimin dhe ekspozimin për një kohë të gjatë në internet të fëmijëve. Si rezultat i masave të kufizimit, fëmijët kanë qëndruar dhe vazhdojnë të qëndrojnë gjithnjë e më shumë në internet dhe, kuptueshëm, në kontakt me rrjetet sociale, qoftë për qëllime të edukimit ose edhe argëtimit apo të tjera me karakter social (ruajtja e kontakteve me miqtë dhe shokët), etj. Në këtë kuptim, institucionet arsimore, duhet të rrisin përpjekjet për komunikim, të cilat duhet të synojnë rritjen e ndërgjegjësimit të të rriturve, për masat që ata mund të ndërmarrin për të mbrojtur fëmijët e tyre, ndërkohë që lundrojnë e mësojnë në internet. Sigurisht, është e rëndësishme, që të veprohet në mënyrë parandaluese, duke rritur ndërgjegjësimin e tyre mbi rreziqet e mundshme dhe pasojat afatgjata të ndarjes së informacionit personal në internet. Fëmijët duhet po ashtu, të jenë në gjendje të identifikojnë, kuptojnë dhe të përballen me informacionet me përmbajtje të dëmshme. Për më tepër, privatësia është ngushtësisht lidhur me sigurinë. Privatësia *online* është një nga çështjet më komplekse etike dhe ligjore, që kanë lidhje me internetin.

Institucioni i Avokatit të Popullit, vlerëson komunikimin zyrtar me institucionin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për të bashkëpunuar dhe bashkërendur punën për sfidat e hasura gjatë aplikimit të të mësuarit *online*. Gjithashtu, nisur edhe nga parimi i të “mësuarit nga përvoja”, domosdoshmërisht lind nevoja e

---

<sup>1</sup> Për këtë qëllim, u jemi drejtuar katër Drejtorive Rajonale Arsimore në vend, nëpërmjet komunikimit *online* me sugjerimet tona për të garantuar një proces të sigurt të të mësuarit në distancë dhe, në respekt të mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të nxënësve.

përmirësimin e kuadrit ligjor, për të bërë të mundur përfshirjen e platformës së të mësuarit *online*, si një prej formave alternative të procesit të edukimit por edhe ofrimin e disa garancive të nevojshme për fëmijët gjatë këtij procesi.

Në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës në interesin më të lartë të tyre, institucioni i Avokati i Popullit, në mbështetje të nenit 21 dhe 24, shkronja “a”, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

### **REKOMANDON:**

-Rishikimin e kuadrit ligjor ekzistues në fushën e arsimit parauniversitar e më gjerë, për parashikimin e ngritjen e platformave të studimit *online*, si një prej formave kryesore të të nxënësve, sot në epokën digjitale.

-Forcimin e punës për përsosjen e marrëdhënieve mësues-fëmijë/nxënës: marrëdhënie bashkëpunimi për arritjen e realizimit të objektivave të përbashkëta, ku një ndër të rëndësishmit është edhe parandalimi i çdo forme shkeljeje të të drejtave të tyre, edhe në këtë periudhë të pazakontë pandemie.

-Forcimin e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të respektimit të të drejtave të fëmijëve dhe vendosjen e të drejtave të fëmijëve në zemër të vullnetit e të procesit të mësimdhënies.

-Aplikimin e një metodologjie të pedagogjisë e didaktikës, të bazuar në të drejta, për të siguruar, që fëmijët dhe të rinjtë, të mësojnë në një mjedis ku respektohen këto të drejta.

-Marrjen e masave nga MASR, gjatë procesit të të mësuarit *online*, për dhënien e informacionit të saktë dhe fakteve të bazuara në shkencë rreth COVID-19, për t'i ardhur në ndihmë fëmijëve në zvogëlimin e frikës dhe ankthit rreth sëmundjes, duke i mundësuar të përballojnë çdo efekt apo ndikim që do të ketë ky virus në jetën e tyre. Transmetimet *online* duhet t'iu ofrojnë nxënësve informacion jetik për pastrimin e duarve dhe masave të tjera për të mbrojtur veten, të ofrojnë mbështetje për shëndetin mendor, t'i ndihmojnë nxënësit të jenë të sjellshëm ndaj njëri-tjetrit dhe të shmangin stereotipet kur flasin për virusin.

-Marrjen e masave, për organizimin e procesit të mësimdhënies në televizion, edhe në gjuhën e shenjave, duke i ardhur në ndihmë fëmijëve me aftësi të kufizuara.

-Marrjen e masave, për verifikimin e situatës, në të gjitha shkollat, për të rritur ndërgjegjësimin për rreziqet e internetit të pasigurt e të pakontrolluar, ndaj fëmijëve.

-Ruajtjen e privatësisë dhe imazheve të fëmijëve-nxënës, gjatë procesit të të mësuarit *online*, dhe konsolidimin e komunikimit në vijimësi, ndërmjet mësuesve dhe prindërve në këtë kontekst, si konsideratë mjaft thelbësore.

-Marrjen e masave për monitorimin e mësimit *on line*, në rastet kur fëmijët dhe mësuesit nuk kanë akses në internet ose në telefoni mobile. Kjo problematikë është prezente dhe e dukshme edhe tek fëmijët e familjeve që janë në çadra, si pasojë e tërmetit të 26 nëntorit 2019, si dhe në familjet përfituese të skemës së Ndhmës Ekonomike, që kanë akses të kufizuara në internet dhe mediat *on line* për shkak të mungesës së mallrave bazikë (psh tv).

Në mbështetje të nenit 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në frymën e legjislacionit të ri të mbrojtjes së fëmijës, drejt qasjes së bashkërendimit dhe koordinimit ndërsektorial në nivel qendror dhe vendor, si dhe në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi.

## **K O M I S I O N E R**

**Nejla PEKA**